




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.528/2023
Datë: 27 nëntor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 24 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 26 të Rregullores Nr.15/2022 për statusin, të drejtat, detyrimet, performancën, disiplinimin, transferimin, trajnimet, dhe përfundimin e marrëdhënies së punës të Bashkëpunëtorit Profesional, në takimin 317-të, të mbajtur më datë 27 nëntor 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e z.Venhar Salihu, kryetar i Gjykatës Themelore në Gjilan, për angazhimin/transferimin e përkohshëm të bashkëpunëtorit profesional z. Irfan Thaqi, për 3 (tre) muaj nga data 1 dhjetor 2023, në Gjykatën Themelore në Gjilan – Dega Kamenicë.
- II. Vendimi hyn në fuqi më datë 27 nëntor 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nga kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan z. Venhar Salihu, ka pranuar kërkesën për transferim të përkohshëm të z.Irfan Thaqi, bashkëpunëtor profesional, nga Gjykatën Themelore Gjilan në degën e Kamenicës. Kërkesën e ka mbështetur në interes të gjyqësorit, me qëllim të funksionimit sa më të mirë të degës në Kamenicë e cila aktualisht është në mungesë të bashkëpunëtorëve profesional.

Në takim të mbajtur më 27 nëntor 2023, Këshilli pas shqyrtimit të kërkesës së kryetarit Salihu dhe gjyqtarës mbikëqyrëse në degën e Kamenicës znj. Dërvodeli, vendosi që të aprohet kërkesa si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ



Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Venhar Salihu, Kryetar në Gjykatën Themelore Gjilan;
- Z. Irfan Thaqi, bashkëpunëtor profesional në Gjykata Themelore Gjilan;
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në SKGJK;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.